



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA TELEGRAFIKE SHQIPTARE

DEKRET

MBI AGJENCINË TELEGRAFIKE SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 58 pika 6 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

Me propozimin e Qeverisë,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

Bërë këtë dekret:

DEKRET MBI AGJENSINE TELEGRAFIKE SHQIPTARE.

Neni 1.

Agjencia Telegrafike Shqiptare (A.T.SH) është agjencia zyrtare e Republikës Popullore të Shqipërisë që informon mbi mbi aktivitetin e vendit e mbi marje ndërkombëtare.

Neni 2.

Agjencia Telegrafike Shqiptare ka për detyrë:

- a)ti informojë mbi të gjithë aktivitetin politik, ekonomik, kulturor dhe shoqëror që zhvillohet në të gjithë territorin e Republikës
- b)t'i bëjë të njohur botës së jashtëme luftë e vendosur të popullit Shqiptar për mbrojtjen e paqës dhe ndërtimin e bazave të socializmit, popullin paqësore të qeverisë shqiptare dhe të gjithë sukseset që arrihen në banorët e ndryshëm të aktivitetit të vendit;

c) t'i informojë shtypin, radion dhe organe të tjerë të interesuara mbi marrjet ndërkombëtare. T'i japi këto shpejt dhe me saktësinë më të madhe. Të drejtat për të ushtruar këtë detyrë i takon vetëm Agjencisë Telegrafike Shqiptare.

ç) Të popullarizojë me anën e fotografive brënda dhe jashtë vendit, gjithë aktivitetin politik, ekonomik, kultural dhe shoqëror që zhvillohet në vend. T'u sigurojë nga bota e jashtme shtypit dhe organizatat e interesuara, fotografi të përshtatshme për qëllimet e tyre.

Neni 3.

Për kryerjen e këtyre detyrave Agjencia Telegrafike Shqiptare ka të drejtë:

a) të ketë në posedim dhe të përdorë stacione radiofonike dhe telegrafike, të përdorë shërbimet telegrafike dhe telefonike të shteti, mjete të tjera komunikacioni. Për kryerjen e shpejtë të shërbimit organet e P.T.T. dhe të komunikacioneve, duhet t'i jhapim prioritet AGJENSIA TELEGRAFIKE SHQIPTARE

b) të ketë korrespondencë brënda vendit dhe kur të shihet e nevojshme edhe jashtë shtetit:

c) të lidhë kontratë me agjensi të huaja të lajmeve ose të fotove për përdorimin e informatave ose të fotografive të tyre për qëllimet përfituara në nenin 2. gërma c dhe ç.

Neni 4.

Agjencia Telegrafike Shqiptare ruan të drejtën e autorit mbi të informatat dhe materialin tjetër që shpërndahet prej saj 48 orë pas të dhënies së tyre, buletinin e agjencisë. Askush nuk ka të drejtë të përdorë pa qënë i autorizuar prej Agjencisë Telegrafike Shqiptare dhe pa përdorur burimin e marrjes.

Neni 5.

Agjencia Telegrafike Shqiptare shpërndan informatat e saj dhe material tjetër kundrejt pagesës dhe në këtë rast lidh kontratë me çdo agjensi kush është e

interesuar.Për çdo shtrembërim ose përdorim të informatave në kundërshtim me realitetin e Agjensisë Telegrafike Shqiptare ka të drejtë ti ankohet organeve të drejtësisë për mbrojtjen e të drejtave të saj.

Neni 6.

Të gjitha informatat që organet shtetërore ose organizatat shqiptare duhet t'ia bëjnë të ditura popullit i dorëzohen Agjensisë Telegrafike Shqiptare.

Me dispozita të Qeverisë do të caktohen çështjet për të cilat informohet Agjensia Telegrafike Shqiptare dhe mënyra e informimit.

Neni 7.

Gjithë organet e shtetit dhe të organizatave shoqërore kanë detyrë të ndihmojnë Agjensinë Telegrafike Shqiptare në kryerjen e detyrave të saj.

Neni 8.

Agjensia Telegrafike Shqiptare varet nga Këshilli i Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, i cili cakton strukturën dhe rregullat e pozicionimit të saj.

Neni 9.

Ky dekret hyn në fuqi menjëhere.

Tiranë, më 9.11.1954

Nr.i dekretit : 1960

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPERISE

SEKRETARI:
SAMI BAHOLLI

KRYETARI:
HAXHI LLESHI